

KRU "GJAKOVA" SH.A Gjakovë			
Data e kërkesës: 22.12.2023			
Nr. akti/orig.	Titulli	Shtetësi	Vlera
	3655		

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO		ARRU
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority		
Nr. prot./Prot. No./Prot. No.	811/02	
Nr. akti/Act/Act No.	D	
Nr. shërb./Shërb. No./Shërb. No.	24.12.2023	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITETI ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY




Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14.01.2016, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. 811/D datë 21.12.2023 nga Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Gjakova", për aprovimin e Rregullores me Nr. 07/2023 për Matjen, Instalimin dhe Leximin e Pajisjeve Matëse të Ujit, me datën 22.12.2023, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja Nr. 07/2023 për Matjen, Instalimin dhe Leximin e Pajisjeve Matëse të Ujit, me anekset, si në vijim:
 - 1.1. Formati i Raportit të Kontrollit të Ujëmatësit të Konsumatorit,
 - 1.2. Formati i Raportit të Kontrollit të Ujëmatësit të Prodhimit,
 - 1.3. Formati i Urdhërësës së Punës për Instalim të Ujëmatësit,
 - 1.4. Forma e Kërkesës për Verifikimin e Saktësisë së Ujëmatësit,
 - 1.5. Tabela Udhëzuese për Dimensinimin e Ujëmatësve,
 - 1.6. Forma e raportit të sasisë së ujit të përpunuar
2. Për zbatimin e kësaj Rregullore, e cila është shtojcë e këtij vendimi, obligohet të përkujdeset Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Gjakova", SH.A me seli në Gjakovë,
3. Rregullorja e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, fillojnë së zbatuari 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të KRU "Gjakova",
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

Shtojcë e këtij vendimi: Rregullorja e miratuar me Nr. 07/2023 për Matjen, Instalimin dhe Leximin e Pajisjeve Matëse të Ujit.

T'i dërgohet;
Ix Arkivit të ARRU
Ix Kryeshefit Ekzekutiv KRU "Gjakovë"

Drejtoresha e ARRU

Hajrije MORINA

KRU. "GJAKOVA" SHA. Gjakovë			
Marrë në datën: 05.01.2024			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	956		

RREGULLORE NR. 07 /2023
PËR MATJEN E UJIT, INSTALIMIN DHE LEXIMIN E PAJISJEVE
MATËSE TË UJIT

Në mbështetje të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, dhe të nenit 7, paragrafi 2 të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve të KRU "Gjakova" Sh.A.

Nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR MATJEN E UJIT, INSTALIMIN DHE LEXIMIN E PAJISJEVE MATËSE TË UJIT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i dhe Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim:

1.1 rregullimin e matjes së ujit në pikat e prodhimit / trajtimit të ujit dhe ujit të konsumuar nga konsumatorët.

1.2 përcaktimin e rregullave dhe procedurave për instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e ujëmatësve.

2. Kjo Rregullore zbatohet nga Kompania në tërë zonën e shërbimit për të cilën është e licencuar

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon;

1.1. **Autoriteti** – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit;

1.2. **AMK** – Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;

1.3. **Ditë Pune** - çdo ditë përveç të shtunës, të dielës dhe ndonjë dite tjetër që është festë zyrtare në Republikën e Kosovës;

1.4. **Ekip i kontrollit** – ekipë e formuar nga Kompania për kontrollimin e ujëmatësve;

1.5. **Faturë** - dokumenti i cili i dërgohet konsumatorit nga Kompania për të paguar detyrimet për shërbimet e ofruara;

1.6. **Konsumatori** - Personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me Kompaninë dhe/ose që merr shërbime nga Kompania;

- 1.7. **Konsumator pasiv** - konsumatori i cili për arsye të ndryshme dëshmon se përkohësisht nuk i shfrytëzon shfrytëzon shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit mirëpo vazhdon të mbetet i lidhur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- 1.8. **Kontrata e shërbimit** - kontrata standarde e cila duhet të lidhet mes Kompanisë dhe konsumatorit, e cila rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palëve;
- 1.9. **Kompania** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Gjakova” SH.A.;
- 1.10. **Ujëmatësi** - çdo aparat apo pajisje që përdoret nga Kompania për të matur sasinë e ujit të përpunuar dhe të konsumuar;
- 1.11. **Ujëmatës i konsumatorit** - çdo aparat apo pajisje që përdoret nga Kompania për të matur sasinë e ujit të konsumuar nga konsumatori;
- 1.12. **Ujëmatës kontrollues** - çdo aparat apo pajisje që përdoret nga Kompania për të matur sasinë e përgjithshme të ujit të konsumuar në ndërtesat e banimit kolektiv dhe objekte afariste;
- 1.13. **Ujëmatës në pikat e prodhimit / trajtimit** - çdo aparat apo pajisje që përdoret nga Kompania për të matur sasinë e ujit të prodhuar dhe të trajtuar;
- 1.14. **Lexuesi i ujëmatësit** – është personi i autorizuar nga Kompania për lexim të ujëmatësit të konsumatorit dhe ujëmatësit kontrollues;
- 1.15. **Ekipi i kontrollës** – ekipë e autorizuar nga Kompania për të kryer kontrollimin e ujëmatësve.

Neni 3:

Parimet për matje të ujit

1. Kriteret tekniko-metrologjike dhe standardet e konformitetit të ujëmatësit duhet të jenë në pajtueshmëri me normat e përcaktuara nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK).
2. Secila pikë prodhimi / trajtimi e ujit, që është në shfrytëzim nga Kompania, duhet të ketë të instaluar ujëmatës funksional, specifikat e të cilit janë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.
3. Secila pikë e konsumit të ujit duhet të ketë të instaluar ujëmatës funksional, specifikat e të cilit janë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.
4. Në ndërtesat e banimit kolektiv, Kompania është e obliguar të instalojë ujëmatës kontrollues për tërë objektin.
5. Në objekte afariste me më shumë se 10 (dhjetë) pika konsumuese, preferohet që Kompania të instalojë ujëmatës kontrollues për tërë objektet.
6. Në rastet kur vërtetohet që vëllimi i ujit në hyrje ndryshon nga vëllimi i ujit që shkarkohet nga bizneset dhe industria atëherë të njëjtit duhet të instalojnë ujëmatës funksional në pikat e shkarkimit.

KAPITULLI II

STANDARDET PËR PËRZGJEDHJEN E UJËMATËSIT

Neni 4:

Kriteret teknike për ujëmatësin

1. Ujëmatësi duhet të plotësojë kriteret e konformitetit dhe kërkesat tekniko-metrologjike sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të jetë i aprovuar paraprakisht nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK).
2. Kompania para se të pranojë ujëmatësin, duhet të verifikojë listën me emrat e distributorëve lokal, prodhuesve dhe llojeve/ modeleve të ujëmatësve që janë të aprovuar nga Agjencia për Metrologji e Kosovës (AMK).
3. Ujëmatësi duhet të instalohet sipas udhëzimeve specifike të prodhuesit të ujëmatësit. Për secilën situatë specifike në terren duhet përzgjedhur lloji adekuat e ujëmatësit.
4. Ujëmatësi i ri preferohet të jetë i pajisur me njësinë për dhënie të pulsit "output pulse unit" për të transmetuar sinjalet e leximit të gjendjes së ujëmatësit tek moduli për lexim automatik "automatic meter reading module" apo tek regjistruerit dhe arkivuesit e të dhënave të leximit "datalogger".

Neni 5

Shenjat në ujëmatës

1. Secili ujëmatës duhet të ketë shenjat identifikuese metrologjike dhe të konformitetit të produktit, që janë kërkesa obligative ligjore, të cilat janë listuar më poshtë:
2. Shigjeta në të dy anët e trupit të ujëmatësit që tregon drejtimin rrjedhjes së ujit.
3. Numrin serik të ujëmatësit.
4. Emrin e prodhuesit dhe markën tregtare ("trademark") të produktit.
5. Presionin maksimal punues të lejuar në njësinë bar.
6. Prurjen nominale në m^3/h .
7. Shkronjën 'H' ose 'V' që tregon nëse ujëmatësi mund të instalohet vetëm në pozitë horizontale ose vertikale.
8. Shënjinin CE që vërteton përputhshmërinë e produktit me kërkesat e zbatueshme me legjislacionin përkatës.
9. Shënjinin plotësues metrologjik që përbëhet nga shkronja e madhe "M" dhe dy shifrat e fundit që tregojnë vitin kur është bërë shënjimi (që korrespondon me datën e prodhimit të ujëmatësit), që janë të rrethuara me një drejtkëndësh. Lartësia e drejtkëndëshit duhet të jetë e barabartë me lartësinë e shenjës CE.

Neni 6

Dimensionimi i ujëmatësit

Dimensionimi i ujëmatësit përcaktohet nga Kompania bazuar në llogaritjet për nevojat për ujë të konsumatorit / aplikuesit për kyçje në rrjetin e ujësjellësit.

KAPITULLI III

LOKACIONI, INSTALIMI DHE MIRËMBAJTJA E UJËMATËSIT

Neni 7

Lokacioni i pusëtës për instalim të ujëmatësit

1. Kompania është e obliguar të përcaktojë lokacionin dhe standardet teknike për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e pusëtës ku është instaluar ujëmatësi.
2. Konsumatori është i obliguar që për instalimin e ujëmatësit të sigurojë lokacion sipas kërkesave të Kompanisë.
3. Lokacioni për ujëmatësin duhet të jetë në vend të përshtatshëm që mundëson qasje të lehtë për stafin e Kompanisë për qëllime të instalimit, leximit, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të ujëmatësit.
4. Puseta duhet jetë me dimensione të mjaftueshme dhe kushte të përshtatshme që mundëson instalimin, leximin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ujëmatësit nga ndikimet mekanike dhe ndryshimet e temperaturës.

Neni 8

Lokacioni i pusëtës së ujëmatësit për shtëpi individuale

1. Lokacioni i pusëtës për ujëmatës për shtëpi individuale mundet të jetë:
 - 1.1. Brenda pronës së konsumatorit, edhe atë:
 - 1.1.1. Jashtë objektit banues dhe sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit.
 - 1.1.2. Në raste të veçanta, kur nuk ka vend për ndërtimin e pusëtës jashtë objektit, me aprovimin e Kompanisë, ujëmatësi mund të instalohet brenda objektit.
 - 1.2. Jashtë pronës së konsumatorit, në hapësirë publike, nëse kështu vlerëson Kompania, me kusht që:
 - 1.2.1. Leja për ndërtimin e pusëtës në pronë publike të sigurohet nga Kompania.
 - 1.2.2. Kostoja e ndërtimit të pusëtës dhe e punimeve për rikthimin e infrastrukturës në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe dëmtimet eventuale të instalimeve gjatë ndërtimit, mbulohen nga Kompania.

Neni 9

Lokacioni i ujëmatësit për ndërtesa të banimit kolektiv

1. Për të gjitha njësitë banesore në ndërtesa të banimit kolektiv, ujëmatësit grupohen dhe vendosen në lokacion të përshtatshëm, me qasje të lehtë dhe të përhershme prej lexuesit.
2. Në rastet e ndërtesave të vjetra ku zgjidhja sipas paragrafit 1 nuk është e mundur, ujëmatësi do të instalohet brenda njësisë banesore sipas udhëzimeve dhe nën mbikqyrje të Kompanisë.
3. Lokacioni për instalim të ujëmatësit kontrollues përcaktohet nga Kompania.

Neni 10

Instalimi dhe zëvendësimi i ujëmatësit

1. Ujëmatësi duhet të instalohet, zëvendësohet apo zhvendoset vetëm nga punëtorët e autorizuar të Kompanisë, apo ndonjë person tjetër nën mbikqyrjen e Kompanisë.
2. Kompania duhet të aplikojë një metodë standarde të instalimit të ujëmatësve që do të ilustruhet përmes skicave me përshkrime tekstuale të hapave të instalimit të ujëmatësit. Skicat duhet të jenë në dispozicion të konsumatorëve dhe personave të angazhuar për instalimin e ujëmatësit.
3. Në çdo rast, pas instalimit të ujëmatësit të ri apo zëvendësimit të ujëmatësit ekzistues, i njëjti duhet të plombohet dhe të bëhet pranimi teknik nga personat e autorizuar të Kompanisë.
4. Kompania është e obliguar të mbajë shënime për lokacionin (koordinatat) e ujëmatësve dhe detajet tjera si: lloji/modeli, diametri, numri serik, data e instalimit, gjendja fillestare dhe informacione tjera relevante (sipas Shtojcës 3 të kësaj Rregulloreje).
5. Shpenzimet e blerjes së ujëmatësit të konsumatorit për herë të parë bartet nga konsumatori.
6. Shpenzimet e zëvendësimit periodik të ujëmatësit të konsumatorit mbulohen nga Kompania përmes procesit tarifor.

Neni 11

Mirëmbajtja e ujëmatësit

1. Kompania është e obliguar të hartoj dhe zbatoj një program për menaxhimin e ujëmatësve që përfshinë edhe mirëmbajtjen e rregullt të ujëmatësve, kostoja e të cilave mbulohet përmes procesit tarifor.
2. Asnjë person i pa-autorizuar nuk guxon të manipulojë apo dëmtojë ujëmatësin apo plumbën e ujëmatësit.
3. Mirëmbajtja dhe riparimi / zëvendësimi i ujëmatësit, i instaluar në pronën e konsumatorit, kur konstatohet se dëmtimi është shkaktuar nga pakujdesia apo me dashje, përgjegjësia për mbulimin e koston bartet nga konsumatori.
4. Mirëmbajtja dhe riparimi / zëvendësimi i ujëmatësit të konsumatorit, i instaluar në pronë publike është përgjegjësi të Kompanisë.
5. Mirëmbajtja dhe riparimi / zëvendësimi i ujëmatësit kontrollues është përgjegjësi e Kompanisë.

6. Mirëmbajtja dhe riparimi / zëvendësimi i ujëmatësit të instaluar në pikat e prodhimit / trajtimit është përgjegjësi e Kompanisë.
7. Në rast se ujëmatësi apo plomba e ujëmatësit manipulohet nga konsumatori, Kompania pas konstatimit të një veprimi të tillë do t'ia ndërpres konsumatorit shërbimet e ujësjellësit brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e zbulimit. Po ashtu, Kompania ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ku do të vlerësohet edhe dëmi i shkaktuar nga konsumatori për mbulimin e:
 - 7.1. Shpenzimeve të riparimit të ujëmatësit dhe/ose plombës;
 - 7.2. Faturimit për konsumin e vlerësuar të ujit që konsiderohet se është konsumuar nga konsumatori e nuk është regjistruar në ujëmatës. Vlerësimi i ujit të konsumuar do të bëhet në bazë të konsumit të periudhës korresponduese të vitit paraprak.

KAPITULLI IV

KONTROLLA, VERIFIKIMI / TESTIMI I UJËMATËSIT

Neni 12

Kontrolla e ujëmatësit

1. Kompania zhvillon kontrolla rutinore, të rastësishme dhe të planifikuara për të verifikuar funksionalitetin e ujëmatësve dhe konsiston në:
 - 1.1. Kontrollë rutinore për ujëmatësit e konsumatorëve dhe ujëmatësit kontrollues që kryhen nga lexuesi i ujëmatësve;
 - 1.2. Kontrolla rutinore për ujëmatësit në pikat e prodhimit / trajtimit të ujit që kryhen nga personat e autorizuar nga Kompania;
 - 1.3. Kontrolla të planifikuara dhe të rastësishme të ujëmatësit që kryhen nga ekipet e autorizuar të kontrollit.

Neni 13

Kontrolla rutinore e ujëmatësit

1. Kontrolla rutinore e ujëmatësit të konsumatorëve dhe ujëmatësit kontrollues realizohet nga lexuesi me rastin e leximit të ujëmatësit, që nënkupton kontrollën vizuale dhe përfshinë:
 - 1.1. Gjendjen e pusëtës;
 - 1.2. Rrjedhjet eventuale të dukshme;
 - 1.3. Funksionalitetin e ujëmatësit, gjendjen e plombës dhe parregullësi tjera;
2. Kontrollat rutinore të gjendjes dhe funksionalitetit të ujëmatësit në pikat e prodhimit / trajtimit realizohen nga personi i autorizuar dhe përfshinë:
 - 2.1. Gjendjen dhe kushtet e objektit ku është instaluar ujëmatësi;
 - 2.2. Funksionalitetin e ujëmatësit.

3. Personi që kryen kontrollën sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni duhet të mbajë shënime dhe të raportojë tek eprori përgjegjës për gjetjet nga kontrolla e realizuar (sipas Shtojcës 1 dhe 2).

Neni 14

Kontrolla e planifikuar dhe e rastësishme e ujëmatësit

1. Kontrolla e planifikuar e ujëmatësit nga ekipi e kontrollit duhet të kryhet sipas planit të hartuar dhe aprovuar nga Kompania që përfshinë:
 - 1.1. Qasjen tek vendndodhja e ujëmatësit;
 - 1.2. Kushtet e pusetës / objektit ku është instaluar ujëmatësi;
 - 1.3. Pengesat / problemet eventuale për leximin e ujëmatësit;
 - 1.4. Instalimin e ujëmatësve sipas standardeve dhe udhëzimeve të Kompanisë;
 - 1.5. Verifikimin e llojit, numrit serik dhe shënimeve tjera relevante në ujëmatës;
 - 1.6. Krahasimin e gjendjes aktuale me leximin paraprak;
 - 1.7. Verifikimin e keqpërdorimeve apo lidhjeve të paligjshme eventuale;
 - 1.8. Verifikimin e plumbës dhe manipulimin eventual të ujëmatësit;
 - 1.9. Funksionalitetin e ujëmatësit.
2. Kontrolla e rastësishme e ujëmatësit nga ekipi e kontrollës kryhet sipas kërkesave të veçanta të Kompanisë dhe palëve të tjera.
3. Gjetjet nga kontrolla në teren duhet të përmbliidhet në procesverbal apo raporte të detajuara, përfshirë provat materiale nga terreni.

Neni 15

Verifikimi / testimi i saktësisë së ujëmatësit

1. Verifikimi / testimi i saktësisë së ujëmatësit bëhet bazuar në kërkesat e legjislacionit përkatës të zbatueshëm të AMK, sipas:
 - 1.1. Programit të hartuar nga Kompania;
 - 1.2. Me kërkesë të konsumatorit në rastin e ujëmatësit të konsumatorit (sipas Shtojcës 4 të kësaj Rregulloreje);
 - 1.3. Me kërkesë të veçantë të Kompanisë apo palëve tjera (sipas Shtojcës 4 të kësaj Rregulloreje);
2. Verifikimi i saktësisë së matjes së ujëmatësit kryhet vetëm në laboratorët e akredituara për këtë qëllim;
3. Rezultatet e verifikimit / testimit të ujëmatësit të konsumatorit do të dorëzohen palës ankuese, ndërsa Kompania do të mbajë në dosje një kopje të rezultatit të testimit.
4. Para se të kryhet verifikimi / testimi, konsumatori do të njoftohet për koston që ai duhet të paguajë dhe duhet të plotësojë formularin e aplikacionit (sipas shtojcës 4 të kësaj Rregulloreje).

5. Nëse konstatohet se ujëmatësi regjistron jashtë kufijve të matjes e në dëm të konsumatorit, Kompania do të mbulojë të gjitha kostot e verifikimit dhe zëvendësimit të ujëmatësit.
6. Nëse ujëmatësi ka regjistruar më tepër, Kompania do të bëjë korrigjimet e nevojshme të faturës(ave) të konsumatorit, bazuar në konsumin mesatar të periudhës korresponduese të vitit paraprak. Korrigjimi aplikohet në mënyrë retroaktive për një periudhë maksimum 3 muajore nga data e testimit të ujëmatësit.

KAPITULLI V

LEXIMI I UJËMATËSIT DHE RAPORTIMI

Neni 16

Leximi i ujëmatësit të konsumatorëve

1. Leximi i ujëmatësit bëhet nga lexuesi i ujëmatësve apo personi i autorizuar i Kompanisë, të cilët duhet të bartin ndonjë shenjë të identifikimit të Kompanisë: uniforma dhe karta të identitetit të lëshuara nga Kompania, të cilat duhet të reklamohen në vend të dukshëm.
2. Konsumatori duhet ti mundësojë lexuesit të ujëmatësit qasjen tek ujëmatësi brenda pronës së tij.
3. Leximi i ujëmatësit duhet të bëhet në intervale të rregullta, në ditët kalendarike të përafërta të ciklit lexues, jo më shpesh se një (1) herë në muaj dhe jo më rrallë se çdo tre (3) muaj në raste të veçanta.
4. Leximi i ujëmatësit mund të bëhet edhe nga konsumatori, nëse Kompania dhe konsumatori merren vesh me shkrim për një formë të tillë të leximit. Kompania në këto raste do të verifikojë leximin e ujëmatësit në intervale të caktuara kohore, ashtu siç e konsideron të arsyeshme, por jo më rrallë se një (1) herë në vit.
5. Për rastet kur leximi i ujëmatësit bëhet nga distanca, për ujëmatësit e pajisur me module të leximit automatik, lexuesi duhet të verifikojë fizikisht ujëmatësin së paku dy (2) herë në vit.
6. Leximi i ujëmatësit në objektet e kultit do të bëhet nga ofruesi i shërbimeve në intervale të caktuara kohore, ashtu siç e konsideron të arsyeshme, por jo më rrallë se një herë në gjashtë (6) muaj.
7. Në rastet kur konsumatori kërkon të jetë përkohësisht pasiv, ai është i obliguar të ketë ujëmatës funksional të instaluar dhe të ketë arritur marrëveshje me shkrim me Kompaninë. Verifikimi i gjendjes së ujëmatësit të konsumatorëve pasiv do të bëhet nga Kompania së paku një (1) herë në vit. Në këto raste konsumatori do të ngarkohet vetëm me tarifën fikse sipas tarifave të përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 17

Leximi i ujëmatësit në pikat e prodhimit / trajtimit të ujit

1. Leximi i ujëmatësit bëhet nga personi i autorizuar i Kompanisë në baza mujore prej datës 1 (një) dhe jo më vonë se data 5 (pesë) e secilit muaj (sipas Shtojcës 2 të kësaj Rregulloreje).
2. Përveç përdorimit të aplikacioneve softurike, për secilin vendburim të ujit Kompania duhet të mbajë një libër / ditar pune ku shënohen të dhënat e leximeve mujore duke përfshirë datën e leximit, leximin paraprak, leximin aktual dhe vëllimin e ujit të prodhuar / trajtuar në m³. Në rastet kur leximi i ujëmatësit shfaqet në aplikacionin SCADA, Kompania është e obliguar që periodikisht të krahasojë gjendjen fizike në ujëmatës me gjendjen e shfaqur në softuerin SCADA.
3. Personi i autorizuar për lexim të ujëmatësit të prodhimit duhet të mbahet përgjegjës për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të lexuara dhe për mirëmbajtjen e librave / ditarëve për secilin burim. Në varësi prej kushteve tek vendburimi, libri / ditari mbahet në objektin tek burimi apo në zyre të përshtatshme.
4. Personi i autorizuar për lexim të ujëmatësve të prodhimit do të vë në dispozicion dhe do të arsyetojë çdo lexim para palëve të treta dhe institucioneve mbikëqyrëse.
5. Personi i autorizuar për lexim të ujëmatësit të prodhimit do të mbahet përgjegjës për të paraqitur dhe lajmëruar menaxhmentin e Kompanisë për mosfunksionim të ujëmatësit të prodhimit. Çdo ndodhi me rëndësi lidhur me pikën e prodhimit / trajtimit dhe ujëmatësin duhet të jetë e evidentuar në librin / ditarin e pikës së prodhimit / trajtimit. Nëse ka ndërhyrje apo korigjim të dhënave, personi i autorizuar për lexim të njëjtat duhet të i sqarojë me shkrim në ditar, si dhe me kërkesë të organeve mbikëqyrëse duhet të japë sqarime plotësuese.

Neni 18.

Mirëmbajtja dhe raportimi për ujin e prodhuar

1. Kompania përcakton hierarkinë e raportimit të ujit nga pikat e prodhimit / trajtimit tek zyrtari përgjegjës i Kompanisë për të ruajtur dhe përditësuar të dhënat e prodhimit të ujit.
2. Zyrtari përgjegjës i Kompanisë duhet t'i sistemojë të dhënat për matjen e ujit nga të gjitha pikat e prodhimit / trajtimit në një format lehtë të auditueshëm; aplikacion softuerik dhe kopje në letër.
3. Raportimi i të dhënave të ujit të prodhuar tek institucionet mbikëqyrëse bëhet nga zyrtari përgjegjës i kompanisë në baza të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore, sipas kërkesave ligjore.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Neni 19 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr.05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit.

Neni 20 Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas aprovimit nga Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Kompanisë.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve



Datë: 27.12.2023

Shtojca 1: Formati i Raportit të Kontrollit të Ujëmatësit të Konsumatorit

Nr. i regjistrimit:

Datë:

RAPORTI I KONTROLLËS SË UJËMATËSIT TË KONSUMATORIT

Konsumatori/Personi:

Adresa:

Nr. Personal/Nr. Bisnesi:

Kodi i konsumatorit:

✓ **Lloji i kontrollës:**

<input type="checkbox"/> Kontrollë rutinore	<input type="checkbox"/> Kontrollë e planifikuar	<input type="checkbox"/> Kontrollë e rastësishme
---	--	--

• **Përshkrimi i Konstatimit**

Prodhimi i Ujëmatësit		Lloji i Ujëmatësit	
Diametri i Ujëmatësit		Numri i Ujëmatësit	
Gjendja (Leximi) e Faturuar e Ujëmatësit		Gjendja (Leximi) Aktual i Ujëmatësit	
Ujëmatësit Funktionon po/jo			
Vula e Ujëmatësit (pllomba) (po/jo)			

• **Shënime:**

Lexuesi / Ekipi i kontrollit të Kompanisë

Konsumatori

1

2

3

Shtojca 2: Formati i Raportit të Kontrollit të Ujëmatësit të Prodhimit

Nr. i regjistrimit:

Datë:

RAPORTI I KONTROLLIT TË UJËMATËSIT TË PRODHIMIT

Pika e prodhimit / trajtimi:

Adresa:

✓ **Lloji i kontrollës:**

<input type="checkbox"/> Kontrollë rutinore	<input type="checkbox"/> Kontrollë e planifikuar	<input type="checkbox"/> Kontrollë e rastësishme
---	--	--

• **Përshkrimi i Konstatimit**

Prodhimi i Ujëmatësit		Numri Serik i Ujëmatësit	
Diametri i Ujëmatësit		Gjendja Fizike e Ujëmatësit	
Lloji i Ujëmatësit		Gjendja / Leximi Paraprak i Ujëmatësit (m ³)	
Ujëmatësit funksionon po/jo		Gjendja / Leximi Aktual i Ujëmatësit (m ³)	
Vula e Ujëmatësit (pllomba) (po/jo)		Totali i ujit të prodhuar brenda periudhës raportuese (m ³)	

• **Shënime:**

Personi i autorizuar / Ekipi i kontrollit të Kompanisë

Personi përgjegjës i Kompanisë

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____

Shtojca 3: Formati i Urdhëresës së Punës për Instalim të Ujëmatësit

Nr. i regjistrimit:

Data:

**URDHËRESË E PUNËS
PËR INSTALIMIN E UJËMATËSIT**

Për : _____

ëEmri i hidraulikut/mjeshtrit

Të dhënat e Konsumatorit të cilit i është instaluar ujëmatësi i ri:

Emri	_____		
Adresa	_____		
Zona	_____	Kodi i konsumatorit	_____

ëTë plotësohet nga hidrauliku i ngarkuar

INSTALIMI I UJËMATËSIT TË RI		DEMONTIMI I UJËMATËSIT TË VJETËR *	
Emri i Prodhuesit:	_____	Emri i Prodhuesit:	_____
Lloji:	_____	Lloji:	_____
Numri Serik:	_____	Numri Serik:	_____
Diametri nominal (mm):	_____	Diametri nominal (mm):	_____
Prurja nominale (m3/h):	_____	Prurja nominale (m3/h):	_____
Data e instalimit:	_____	Data e demontimit:	_____
Numri i vulës (pllombës):	_____	Leximi i matësit (m3):	_____
Vërejtje :			

** Të plotësohet në rastet kur zëvendësohet ujëmatësi i vjetër*

Instalimi është bërë nga: _____ **Konsumatori:** _____

Kopje:

- Shefit të Departamentit të Shërbimeve të Konsumatorëve
- Operatorit të Faturimit

Konsumatorit

-

Shtojca 4: Forma e Kërkesës për Verifikimin e Saktësisë së Ujëmatësit

Nr. i regjistrimit:

Data:

ËTë plotësohet nga Konsumatori

Unë pajtohem të paguajë të gjitha shpenzimet e demontimit të ujëmatësit dhe testimit të tij në përputhje me tarifat e aplikueshme të KRU "Gjakova"Sh.A. në rast se testimi i ujëmatësit rezulton të jetë i saktësisë së matjes konform standardeve të përcaktuara me ligj.

Emri dhe Mbiemri:	
Adresa:	
Komuna:	
Nr. i telefonit (e-mail adresa):	
Numri i kontratës:	
Numri serik i ujëmatësit:	
Leximi i Ujëmatësit:	
Data e leximit të ujëmatësit:	

Kërkesës ia bashkangjes:

1. _____

2. _____

Nënshkrimi i Konsumatorit: _____

Datë: _____



Shtojca 5: Tabela Udhëzuese për Dimensiononimin e Ujëmatësve

Ujëmatësi			Lloji i Shfrytëzimit
Diametri	Lloji	Prurja	
15 mm (1/2")	Me fushë të thatë 'multi jet'	30-3,000 l/h	Shtëpi individuale, apartament, ose biznes i vogël (deri me 7 persona).
20 mm (3/4")	Me fushë të thatë 'multi jet'	50-5,000 l/h	Shtëpi të mëdha, shtëpi duplex, blloqe banimi, (deri 4 apartamente), dyqan berber, pompa benzine, institucione të vogla.
25 mm (1")	Me fushë të thatë multi jet	70-7,000 l/h	Residenca me pishina, ndërtesë banimi kolektiv me (4–12 apartamente), shkolla të vogla (deri 200 nxënës), institucione (deri 50 staf), kisha, xhami, motele të vogla (deri 10 dhoma), konsumatorë komercial të mëdhenj, kompleks dyqanesh (deri 10).
30 mm (5/4")	Me fushë të thatë 'multi jet'	120-12,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (12–20 njësi), shkolla (deri 300 nxënës), hotele të madhësisë së mesme (deri 20 dhoma), motele (deri 25 dhoma), qendra të vogla tregtare, restorante, spitale të vegjël (deri 60 shtretër).
40 mm (6/4")	Dry dial 'multi jet'	200-20,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (20–40 njësi), shkolla (deri 400 nxënës), hotele të madhësisë së mesme (deri 30 dhoma), motele (deri 40 dhoma), stacione të mëdha të benzinës me autolarje, qendra të vogla tregtare, restorante të mëdha, spitale të vegjël (deri 100 shtretër).
50 mm (2")	Me fushë të thatë 'multi jet'	450-30,000 l/h	Ndërtesa të banimit kolektiv (41–120 njësi), shkolla (deri 2000 nxënës), spitale të madhësisë së mesme ose qendra shoppingu, hotele të mesme apo motele, stacione të mëdha të benzinës me autolarje
75-100 mm	Kombinuar	120-100,000 l/h	Kompleks ose blloqe banimi (120–350 njësi), hotele apo motele të mëdha, spitale, qendra të zyrave, shkolla (mbi 2500 nxënës), qendra të mëdha tregtare, ndërtesa të qeverisë, objekte industriale.

SHTOJCA X: FORMA E RAPORTIT TË SASISË SË UJIT TË PËRPUNUAR

Muaji _____ 2023

Nr.	Datë	Gjendja e mëparshme	Gjendja aktuale	Vëllimi ditor (m3)	Komente
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
Totali					

Përgjegjësi i leximit:

Emri dhe mbiemri
dhe nënshkrimi

Menaxheri i Njësisë
Operative:

Emri dhe mbiemri dhe
nënshkrimi

Menaxheri Teknik i
KRU:

Emri dhe mbiemri
dhe nënshkrimi